



Funded by
the European Union



FTESË PËR OFERTË

Organizata:	HANDIKOS (Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës)
Titulli i kontratës:	Kontratë për shërbime hotelierie
Lokacioni:	Brenda zonës së Prishtinës (në Kosovë)
Data e publikimit:	05/08/2022
Data e mbylljes:	12/08/2022
Data e vlerësimit të ofertave	15/08/2022
Email-i:	handikos@handi-kos.org

1. PËRMBLEDHJE

HANDIKOS (Shoqata e Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve të Kosovës) është themeluar në vitin 1983 me qëllim kryesor arritjen e njohjes dhe pjesëmarrjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri. HANDIKOS lobon dhe avokon në mënyrë aktive në nivel lokal dhe qendror për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, me qëllim të krijimit të një mjedisi gjithëpërfshirës përmes rritjes së mundësive të punësimit, përmirësimit të qasjes në arsim, përfshirjen e PAK në skemat e mirëqenies sociale dhe sigurimeve shoqërore, si dhe përmirësimin e qasjes fizike.

HANDIKOS, në partneritet me Disability Partnership Finland, Threshold (OJQ finlandeze), Shoqatën Kosovare e të Shurdhërve, si dhe Shoqatën e të Verbërve të Kosovës, aktualisht po zbaton projektin e financuar nga BE të quajtur "Promovimi i gjithëpërfshirjes dhe shtrirjes së proceseve konsultative për reformat e qeverisjes dhe administratës publike në sektorin e aftësisë së kufizuar në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal – Kosova gjithëpërfshirëse". Në kuadër të këtij projekti është planifikuar realizimi i një punëtorie 3-ditore, për çka HANDIKOS është duke kërkuar ofertues të cilët ofrojnë shërbime hoteliere brenda zonës së Prishtinës. Të gjithë ofertuesit duhet të përfshijnë shërbimet në vijim:

- Akomodimi për person me "pansion të plotë" (çmimi për dhomë njëshe);
- Salla e trajnimeve e përshtatshme për deri 25 persona;
- Dreka për pjesëmarrës (me një pije jo-alkoolike të përfshirë në çmim; ju lusim theksoni menynë që ofroni)
- Ofrimi i ujit për pjesëmarrës (çmimi për një ujë);
- Ofrimi i kafes për pjesëmarrës (çmimi për një kafe).

2. KRITERET PËR APLIKIM

Të gjithë ofertuesit duhet të plotësojnë këto kritere:

- Duhet të kenë disponueshmëri të akomodimit të 2 personave përgjatë datave 12,13,14,15,16 & 17 Shtator 2022 (6 netë);
- Duhet të kenë disponueshmëri të akomodimit për 1 person përgjatë datave 26,27,28,29 & 30 Shtator 2022 (5 netë);



Funded by
the European Union



- Duhet të kenë disponueshmëri të sallës për trajnime për rreth 25 persona, përgjatë datave 27,28&29 Shtator (3ditë);
- Duhet të ndodhet brenda zonës së Prishtinës (preferohet lokacioni brenda qytetit);
- Duhet të kenë qasje fizike për personat me aftësi të kufizuara në sallë të trajnimeve dhe së paku në një nga dhomat (preferohet tualet i veçantë për personat me aftësi të kufizuara);
- Duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme në sallën e trajnimeve, që siguron akomodimin e deri 25 personave duke respektuar distancën fizike;
- Duhet të ketë hapësirë të mjaftueshme në sallën e trajnimeve, të përshtatshme për punë në grupe, sesion plenar apo format tjetër;
- Duhet të ketë ndriçim të mjaftueshëm dhe hapësirë të përshtatshme për përdorimin e projektorit;
- Duhet të kenë përvojë në ofrimin e shërbimeve të ngjashme me organizata të tjera lokale dhe ndërkombëtare (përvoja me organizata nga fusha e aftësisë së kufizuar është përparësi);
- Është e preferuar të ketë projektor, tabelë për mbajtjen e letrave dhe mundësi për printim.

3. KRITERET PËR PËRZGJEDHJE:

Kriteret për përzgjedhjen e ofertave më të përshtatshme për shërbimet e nevojshme janë:

- Dorëzimi i dokumentacionit të plotë;
- Plotësimi i të gjitha kriterëve për aplikim;
- Çmimi më i lirë.

4. KOHËZGATJA E KONTRATËS DHE KUSHTET E PAGESËS

Pagesa do të bëhet vetëm pas pranimit të shërbimit, përmes transferimit bankar në monedhën e faturimit dhe do të bëhet deri 30 ditë pas marrjes së faturës dhe pranimit të shërbimit. Kohëzgjatja e kontratës do të jetë deri në fund të vitit, përkatësisht 31.12.2022.

5. DOKUMENTET PËR DORËZIM DHE PËRMBAJTJA E OFERTËS:

- Certifikata e regjistrimit të biznesit;
- Çmimet e shërbimeve në euro duke mos përfshirë TVSH-në (HANDIKOS është e liruar nga TVSH) prandaj çmimet duhet të jenë pa TVSH);
- Oferta financiare e ndarë me çmime për: akomodim, sallë, ujë, kafe dhe drekë;
- Oferta duhet të jetë e nënshkruar dhe vulosur/apo me logo zyrtare;

6. UDHËZIM PËR OFERTUESIT

Ofertuesit janë të mirëpritur të dorëzojnë aplikacionet e tyre për shërbime hoteliere në handikos@handi-kos.org, me mbishkrimin: “Oferta për shërbime hoteliere”, më së voni deri më 12/08/2022 ora 16:00. Propozimet e marra pas afatit të caktuar nuk do të merren në konsideratë.

Kjo ofertë është e hapur për të gjithë hotelet/restorantet që janë të regjistruara ligjërisht dhe mund të ofrojnë shërbimet e kërkuara.